



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të Vendimit të Komisionit nr. 1114 datë 04.10.2024 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, berat, Fier dhe Korçë” fton çdo fermer apo grupime fermerësh që prodhojnë perime si: qepë, presh, lakër, lulëlakër, brokoli, kastravec, patate, karrota dhe specia; dhe fruta si: mollë, portokalle, limona, luleshtrydhe dhe dardha të paraqesin pranë Autoritetit të Konkurrencës çdo provë/fakt që vërteton ekzistencën e marrëveshjeve të ndaluara nga ana e grumbulluesve, në dëm të fermerëve prodhues dhe konkurrencës së lirë në lidhje me fiksimin e çmimit.

Autoriteti garanton çdo fermer për ruajtjen e konfidencialitetit dhe anonimitetin përkatës.

Për më tepër, ju lutem konsultoni faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës në <http://caa.gov.al>.